



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
-Këshilli Drejtues-

V E N D I M
Nr.1618, date24.06.2011

Për

“Publikimin e mendimeve dhe komenteve të palëve të interesuara mbi këshillimin publik të realizuar për dokumentin rregullator: “Kushtet Teknike për ndërtimin e infrastrukturës së Rrjeteve Kabllore Urbane dhe Infrastrukturës së Rrjeteve me Fibra Optike Ndërrurbane të Komunikimeve Elektronike ” si dhe qëndrimi i AKEP”

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), i përbërë nga:

- | | |
|---------------------------|---------|
| 1. Z. Piro Xhixho | Kryetar |
| 2. Znj. Alketa Mukavelati | Anëtar |
| 3. Z. Benon Paloka | Anëtar |
| 4. Z. Ibsen Elezi | Anëtar |
| 5. Znj. Zamira Nurçe | Anëtar |

dhe sekretare Znj. Marsida Drushku, në mbledhjen e datës 24.06.2011, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, ligjin nr. 8480, datë 27. 05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike” dhe Rregullores së Brëndshme të AKEP-it, shqyrtoi çështjen me objekt:

Relacionin e grupit të punës “Mbi përfundimin e këshillimit publik të dokumentit rregullator “Kushtet Teknike për ndërtimin e infrastrukturës së Rrjeteve Kabllore Urbane dhe Infrastrukturës së Rrjeteve me Fibra Optike ndërrurbane të Komunikimeve Elektronike””.

BAZA LIGJORE:

1. Neni 7, neni 8, neni 110, neni 114 dhe neni 115 të ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”;

2. Pika 3.10 e dokumentit “Udhëzues për procedurat e këshillimit me publikun” miratuar me VKD nr. 1183, date 10.3.2010.
3. Pika 17 e nenit 21 “Rregullores së Brendëshme të AKEP (ish ERT) miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të ERT-së, Nr. 170, datë 24. 04. 2004, e ndryshuar dhe në fuqi sipas pikës 3 të nenit 138 të ligjit nr. 9918;
4. VKD Nr. 1515, datë 10.03.2011 “Për miratimin për këshillim publik të dokumentit rregullator “Kushtet Teknike për ndërtimin e infrastrukturës së Rrjeteve Kabllore Urbane dhe Infrastrukturës së Rrjeteve me Fibra Optike ndërrbane të Komunikimeve Elektronike””.

K Ë S H I L L I D R E J T U E S:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor te grupit te punes si me poshte:

- raport perfundimtar mbi proceduren e zhvilluar te keshillimit publik dhe perfundimet e tij;
- projektvendim i KD i formatuar dhe arsyetuar;
- mendime formale te paleve te interesuara te depozituara me shkrim ne AKEP; si dhe
- diskutimeve në mbledhje mbi çështjen, duke iu referuar bazës ligjore të sipërcituar,

V Ë R E N:

Dokumentacionin i hartuar nga Grupi i punës është kryer në përputhje me kërkesat proceduriale administrative duke realizuar procesin e konsultimit publik me palët e interesuara, duke shqyrtuar mendimet e tyre, e reflekuar ato në dokumentin rregullator sipas rastit. Komentet e sjella nga keto palë të interesuara si dhe qëndrimet e AKEP në lidhje me to, në referencë me kërkesën ligjore respektive, publikohen.

P Ë R K Ë T O A R S Y E:

Bazuar në pikën 4 të nenin 110, pikën 1 të nenit 115 të ligjit nr. 9918, germën (c) të nenit 7/1, pikën 2 të nenit 17 të ligjit 8530 i ndryshuar si dhe pikën 17, neni 21 të Rregullores së Brendëshme të AKEP, e ndryshuar,

V E N D O S:

1. Të miratojë për publikim mendimet dhe komentet e palëve të interesuara mbi procesin e këshillimit publik të përfunduar për rregulloren “Kushtet Teknike për ndërtimin e infrastrukturës së Rrjeteve Kabllore Urbane dhe Infrastrukturës së

Rrjeteve me Fibra Optike ndërurbane të Komunikimeve Elektronike” si dhe qëndrimin e AKEP (Shtojca bashkëlidhur).

2. Ky vendim te publikohet ne faqen e internetit www.akep.al

Ky vendim hyn në fuqi në datën e miratimit të tij.

K R Y E T A R I

Piro XHIXHO

ANËTARË:

1. Alketa MUKAVELATI

2. Benon PALOKA

3. Ibsen ELEZI

4. Zamira NURÇE

Shtojcë

Mendimet dhe Komente të palëve të interesuara mbi procesin e këshillimit publik të përfunduar për rregulloren “Kushtet Teknike për ndërtimin e infrastrukturës së Rrjeteve Kablore Urbane dhe Infrastrukturës së Rrjeteve me Fibra Optike ndërurbane të Komunikimeve Elektronike” si dhe qëndrimi i AKEP

AKEP paraqet përfundimet e këshillimit publik për dokumentin e publikuar me Vendimin Nr. 1515, datë 10.03.2011 të Këshillit Drejtues.

Ne adrese të AKEP kanë ardhur opinionet nga institucionet e mëposhtme:

- I.** Agjencia Kombetare e Planifikimit të Territorit
- II.** Vodafone Albania
- III.** Albanian Mobile Communications
- IV.** Ministria e Brendshme
- V.** Albtelecom sh.a.
- VI.** MITIK

Ne opinionet e derguara nga këto institucione vlerësohet se një dokument i tillë rregullator kishte kohe që ishte i nevojshëm, për të mundësuar disiplinimin e punimeve infrastrukturore për ndërtimin e rrjeteve të komunikimeve elektronike. Gjithashtu, në këto opinione jepen vlerësime pozitive duke e konsideruar dokumentin të plotë dhe që trajton shumëllojshmeri të problemeve që lidhen me infrastrukturën e rrjeteve.

I. Agjencia Kombetare e Planifikimit të Territorit

Sugjeron si më poshtë:

A. Neni 2. “Zhvillimi i Infrastruktursë së kanaleve kablore nentokesore” të riformulohet si vijon:

2.1 Infrastruktura e një kanali kabllor konsiderohen të gjithë elementet ndërtimore, konstruksionet mbajtëse dhe aksesoret ku vendosen kabllot e bakrit, apo ato me fibra optike, nëpërmjet të cilëve realizohet rrjeti i komunikimit elektronik.

AKEP konstaton se ky formulim është identik me formulimin në dokumentin e publikuar.

2.2 Infrastruktura e rrjeteve kablore duhet të ndërtohet nga subjekte të licensuar për këtë lloj aktiviteti.

AKEP konstaton se ky formulim është identik me formulimin në dokumentin e publikuar.

2.3 Sipermarresi që kërkon të investojë për ndërtimin e infrastruktures së komunikimeve elektronike, përpara fillimit të punimeve, aplikon pranë autoritetit që administron territorin për t’u pajisur me Leje Infrastrukturore sipas përcaktimeve

te Ligjit 10119 “Per planifikimin e territorit” dhe akteve nenligjore te dala ne zbatim te tij.

AKEP mendon se edhe ky formulim eshte i pranueshem, por pervec Ligjit 10119 “Per planifikimin e territorit” dhe akteve nenligjore te dala ne zbatim te tij, per reference te vendoset edhe projekt ligji per te drejten e kalimit i cili eshte ne proces miratimi.

2.4 Sipermarresi, ne momentin e aplikimit per lejen e infrastruktures, duhet te dorezoje perpara Autoritetit qe jep lejen nje Vertetim nga AKEP, ku te konfirmohet qe projekti i paraqitur eshte ne perputhje me kushtet teknike te percaktuara ne kete rregullore.

AKEP mendon se ky sugjerim eshte i papranueshem. Te mbetet ne fuqi formulimi ne Kapitullin “Parime te Pergjithshme” Paragrafi 2.5 ne dokumentin e publikuar.

2.5 Gjate aplikimit per leje infrastrukture investitori duhet te paraqesi nje program ku te percaktohet data e fillimit dhe e perfundimit te punimeve per ndertimin e rrjetit.

AKEP eshte dakord me kete formulim

2.6 Per trasene e planifikuar te kanalit kabllor eshte e nevojshme te mblidhet informacion ne lidhje me nevojat per sherbime te tjera komunale, per te koordinuar planet, nese eshte e mundur, per kapacitetet dhe per periudhen e ndertimit.

AKEP konstaton se ky formulim eshte identik me formulimin ne dokumentin e publikuar.

2.7 Kur kanalet kabllore planifikon t’i ndertoje operatori i infrastruktures, i cili eshte nje operator i telefonise fikse te komunikimeve elektronike, dhe ne planin urbanistik nuk eshte percaktuar kapaciteti i kanaleve kabllore te planifikuara, atehere ky kapacitet duhet te jete 30% me shume se sa eshte e nevojshme per kete operator te rrjeteve te komunikimeve elektronike.

AKEP konstaton se ky formulim eshte identik me formulimin ne dokumentin e publikuar.

2.8 Gjate planifikimit te kapaciteteve te kanaleve kabllore duhen marre parasysh nevojat per te pakten 10 vitet e ardhshme.

AKEP konstaton se ky formulim eshte identik me formulimin ne dokumentin e publikuar.

2.9 Te gjitha lejet qe aplikohen per ndertimin e nje infrastrukture kabllore, ose kopjet e tyre, duhet te jene te disponueshme per inspektim ne terrenin e punes.

AKEP konstaton se ky formulim eshte identik me formulimin ne dokumentin e publikuar.

2.10 Sipermarresi qe planifikon te ndertoje kanal kabllor duhet te bashkepunoje me autoritete lokale per te mbledhur informacion ne lidhje me nevojat per sherbime te tjera komunale, per te koordinuar planet, nese eshte e mundur, per kapacitetet dhe periudhen e ndertimit.

AKEP eshte dakord me kete formulim

2.11 Shtrirja direkt ne toke e kabllave ne rrjetet e komunikimit elektronik eshte e lejuar vetem jashte zonave urbane, ekzistuese ose te parashikuara ne dokumenta planifikimi te miratuara.

AKEP eshte i mendimit qe te mbetet ne fuqi formulimi ne Kapitullin “Parime te Pergjithshme” Paragrafi 2.12 ne dokumentin e publikuar.

2.12 Ne te gjitha rastet e tjera, shtrimi i kabllave duhet bere duke perdorur tubacion ose alternativa te tjera me mundesi nderhyrje pa qene nevoja per rigermim.

AKEP konstaton se ky formulim eshte identik me formulimin ne dokumentin e publikuar.

2.13 Rrjeti shperndares me fibra optike duhet te jete i planifikuar si nje rrjet nentokesor i komunikimeve elektronike, ku kabllot me fiber optike jane te futura ne tubacionet kabllore.

AKEP konstaton se ky formulim eshte identik me formulimin ne dokumentin e publikuar.

2.14 Planifikimi i rrjetit shperndares me fibra optike me kablo qe jane depozituar direkt ne toke nuk eshte i lejuar.

AKEP konstaton se ky formulim eshte identik me formulimin ne dokumentin e publikuar.

2.15 Rrjeti shperndares me kablo bakri apo me fibra optike mund te planifikohet ajror, vetem nese eshte i lejuar nga dokumenti i planifikimit te territorit.

AKEP konstaton se ky formulim eshte identik me formulimin ne dokumentin e publikuar.

2.16 Nuk duhet te kryhen punime ne rruge gjate oreve te trafikut te renduar.

AKEP konstaton se ky formulim eshte identik me formulimin ne dokumentin e publikuar.

2.17 Te gjitha trafiqet e korsive te rruges duhet te jene te hapura gjate oreve te trafikut te renduar.

AKEP konstaton se ky formulim eshte identik me formulimin ne dokumentin e publikuar.

2.18 Kontraktuesi nuk duhet te bllokoje me shume se nje korsi ne secilin drejtim, kur kryhen punime ne kryqezime ose kur hapet kanal ose germohet gjate nje rruge.

AKEP konstaton se ky formulim eshte identik me formulimin ne dokumentin e publikuar.

2.19 Investitori duhet te vendose tabela paralajmeruese (shenja dhe/ose tabela me shigjeta) per drejtimin efektiv te trafikut.

AKEP konstaton se ky formulim eshte identik me formulimin ne dokumentin e publikuar.

2.20 Rikthimi i siperfaqes ne gjendjen e meparshme (mbushja dhe rivendosja e asfaltit) duhet te kryhen ne perputhje me kerkesat e Autoritetit qe ka leshuar lejen e infrastruktures, si dhe me kerkesat teknike te parashikuara ne Nenin 18 te kesaj rregullore.

AKEP eshte dakord me kete formulim

2.21 Te gjitha punimet duhet te kryhen nen kontrollin e Autoritetit qe ka leshuar lejen e infrastruktures.

AKEP eshte dakord me kete formulim

2.22 Sipemarresi duhet te planifikoje ndertimin e infrastruktures se rrjeteve te komunikimit elektronik ne menyre te pershtatshme dhe qe nuk sjell rrezik per pronen e shtetit, ate private, si edhe per interesin publik.

AKEP konstaton se ky formulim eshte identik me formulimin ne dokumentin e publikuar.

2.23 Sipermarresi eshte pergjegjes per demin qe shkaktohet si pasoje e punimeve per ndertimin e infrastruktures se rrjeteve te komunikimit elektronik.

AKEP konstaton se ky formulim eshte identik me formulimin ne dokumentin e publikuar.

2.24 Percaktimet e ketij neni dhe te rregullores ne teresi, i shtohen dhe zbatohen njekohesisht percaktimeve te akteve ligjore ne fushen e planifikimit dhe kontrollit te zhvillimit te territorit.

AKEP konstaton se ky paragraf nuk egziston ne dokumentin e publikuar dhe eshte dakort qe ky paragraf te shtohet.

B. Neni 10, pika 10.1: Pas togfjaleshit “.. zonave urbane..” te shtohet: “ekzistuese ose te parashikuara ne dokumenta planifikimi te miratuara.”. Fraza “....dmth ne zonat me dendesi te ulet te popullsisë” te hiqet .

AKEP mendon qe te mbetet ne fuqi formulimi ne dokumentin e publikuar.

II. Vodafone Albania

- 1.** AKEP e ka permendur bazen ligjore ne tekstin e VKD Nr. 1515 date 10.03.2011, ku ka cituar nenin 20 dhe 21 te Ligjit 9918, me qellim saktesimin se nga buron autoriteti ligjor i AKEP per te miratuar nje rregullore me karakter kaq specifik, sic jane standardet dhe kerkesat teknike per ndertimet e rrjeteve te komunikimit elektronik, sikurse percaktohet edhe ne piken 1.2 dhe 1.3 te tij.

Vodafone Albania konsideron se citimi i bazes ligjore edhe ne tekstin e Draft Rregullores “Mbi kushtet teknike per ndertimin e infrastruktures se rrjeteve kabllore urbane dhe rrjeteve me fibra optike nderurbane te komunikimeve elektronike” eshte nje kusht i domosdoshem, qe rregullorja ne fjale te behet nje akt nenligjor i zbatueshem nga

te gjitha autoritetet e ngarkuara me zbatimin e kuadrit ligjor per dhenien e lejeve sipas legjislacionit te planifikimit te territorit.

Ligji Nr. 9918, date 19.05.2008 “Per komunikimet elektronike”, Neni 8 (Kompetencat e AKEP), pika (r) percakton se AKEP “administron dhe zbaton standarde kombetare dhe nderkombetare, si dhe rregullat teknike ne fushen e komunikimit elektronik”. Nga ana tjetere, Neni 20.1 percakton se “sipermarresit qe ndertojne rrjete.... jane te detyruar te zbatojne kushtet e ketij ligji dhe te akteve te tjera ligjore dhe nenligjore, si dhe rregulloret e nxjerra ne zbatim te ketij ligji”.

Neni 21.1 percakton se rrjetet ne fjale duhet te ndertohen “ne perputhje me kete ligj dhe me aktet ne zbatim te tij, me legjislacionin ne fuqi per planifikimin territorial dhe ndertimin, per mbrojtjen e mjedisit si dhe me standardet e tjera teknike”.

Pra, sic del e qarte nga sa me siper AKEP ka kompetence ligjore qe te miratoje nje rregullore per percaktimin e kushteve teknike per ndertimin e rrjeteve kabllore dhe me fibra optike per komunikimet elektronike, nderkohe qe AKEP duhet te kujdeset qe pjesa e lejeve per ndertimin e rrjetit te percaktohet sipas ligjeve perkatese ne fuqi dhe te jete e integruar me keto ligje dhe nuk mund te percaktohet ne kete rregullore, perndryshe do te dilte jashte kompetences ligjore te AKEP.

Vodafone Albania propozon qe ne fillim te Dokumentit te Keshillimit Publik te percaktohet qarte baza ligjore e lartepemendur qe i jep AKEP kompetence ligjore per te miratuar nje akt te tille nenligjor.

AKEP mendon se nuk eshte objekt i kesaj rregullore trajtimi i rregullave per dhenien e lejeve per ndertimin e infrastruktures. Per kere arsye, ne rregullore ne menyre shume te shkurtuar jane permendur vetem si reference ligjet per Komunikimin Elektronik, per Rregullimin e Territorit dhe projekt ligji per te Drejten e Kalimit. Jane keto ligje qe percaktojne qarte rregullat per te marre lejen per ndertimin e infrastruktures se rrjeteve te komunikimit elektronik.

2. Dokumenti i Keshillimit Publik percakton qarte kushtet teknike per ndertimin e infrastruktures se rrjeteve kabllore urbane dhe rrjeteve me fibra optike nderurbane te komunikimeve elektronike, te cilat perbejne kushtet per marrjen e lejes se infrastruktures sipas Ligjit Nr. 10119 date 23.04.2009 “Per planifikimin e territorit”.

Vodafone Albania konsideron se eshte e domosdoshme citimi dhe integrimi me Ligjin per Planifikimin e Territorit. Ndertimi i nje rrjeti te komunikimeve publike perben infrastrukture publike ne kuptimin e Nenit 3.30 te Ligjit per Planifikimin e Territorit, si dhe per punimet ne rrjetet e infrastruktures publike te telekomunikacioneve, ne kuptim te ketij ligji sipermarresit pajisen me Leje Infrastrukture. Vodafone Albania veren se ne Dokumentin e Keshillimit Publik, Neni 2 i tij, AKEP i referohet leje ndertimi.

Per sa me lart, Vodafone Albania propozon qe ne Dokumentin e Keshillimit Publik te zevendesohet fjala “leje ndertimi” me leje infrastrukture ne kuptim te legjislacionit per planifikimin e territorit”.

Me konkretisht, Vodafone Albania kerkon zevendesimin e termit leje ndertimi me termin leje infrastrukture ne pikat 2.4, 2.5, 2.6, 2.21, 2.22, 7.3, 11.1.A dhe 18.1.A .

AKEP e konsideron me vend kete propozim dhe emertimi "Leje Ndertimi" te zevendesohet me "Leje Infrastruktura".

3. Sic e permendem edhe me lart, qellimi i ketij Dokumenti te Keshillimit Publik eshte percaktimi i kushteve teknike per ndertimin e infrastruktures se rrjeteve kabllore urbane dhe rrjeteve me fibra optike nderurbane te komunikimeve elektronike. Vodafone Albania insiston qe ne perputhje me Ligjin Nr. 9918, date 19.05.2008 "Per komunikimet elektronike", Neni 8 (Kompetencat e AKEP), pika (r) ku percaktohet se AKEP "administron dhe zbaton standarde, kombetar dhe nderkombetare, si dhe rregullat teknike ne fushen e komunikimit elektronik", AKEP duhet te shprehet vetem ne percaktimin vetem te kushteve teknike dhe jo te draftoje nje kornize rregullatore duke rrene keshtu ndesh me legjislacionin e planifikimit te territorit ne fuqi dhe te te drejtes se kalimit ne prone te shtetit dhe private, per ndertimin e rrjetit te komunikimeve elektronike qe eshte tashme ne proces miratimi.

Me konkretisht, sipas pikes 2.7 te Dokumentit te Keshillimit Publik, per te projektuar e ndertuar trasene e nje kanali kabllor duhet te mblidhet informacion edhe per nevojat e sherbimeve te tjera komunale per te koordinuar planet, nese eshte e mundur, per kapacitetet dhe periudhen e ndertimit.

Po ashtu, pika 2.11 percakton se sipermarresi qe planifikon rrjetin duhet te bashkepusoje me autoritetet lokale per te mblidhur informacionin per te koordinuar planet, sipas pikes 2.7 .

Ne baze te pikes 3.1 sipermarresi qe planifikon rrjetin duhet te marre informacion nga sipermarresit e rrjeteve egzistuese. Sipas pikes 3.2, ai duhet te marre edhe nje deklarate per vertetesine e informacionit nga ana e sipermarresit tjetere. Sipas pikes 3.3, mungesa e nje deklarate perben shkak per refuzimin e kerkeses per punime tek autoritetet perkatese.

Vodafone Albania konsideron se nje dokument i tille teknik nuk mund te percaktojte kriteret administrative te dhenies se lejeve te zhvillimit dhe infrastruktures sipas kuadrit ligjor ne fuqi. Te gjitha keto tema jane trajtuar ne legjislacionin perkates ekzistues te planifikimit te territorit dhe ne projektligjin e te drejtes se kalimit. Theksojme se legjislacion ekzistues i planifikimit te territorit (neni 78 i tij) dhe projektligji i te drejtes se kalimit (neni 46) percaktojne nje procedure shume te qarte per publikimin e informacionit per shtrirjen e rrjetit si dhe per mbajtjen e nje sistemi te perqendruar informacioni per infrastrukturen e rrjetit te komunikimeve elektronike. Ky informacion mbahet nga AKEP, si dhe nga autoritetet qe kane kompetenca ne fushen e planifikimit te territorit.

Vodafone Albania konsideron se Neni 2.7 dhe Neni 3 duhet te hiqen per arsye se krijojne mbivendosje me kuadrin ligjor ekzistues te planifikimit te territorit dhe projektligjin e te drejtes se kalimit. Per me teper, keto dispozita jane ne kundërshtim me Nenin 8 (Kompetencat e AKEP), pika (r) ku percaktohet se AKEP "administron dhe zbaton standarde, kombetare dhe nderkombetare, si dhe rregullat teknike ne fushen e komunikimit elektronik, sipas te cilit AKEP duhet te miratoje rregullore teknike dhe jo kuader rregullues per dhenien e lejeve per zhvillimin e infrastrukturave te tilla.

AKEP vendos te mbetet formulimi i percaktuar ne Paragrafin 2.7 te dokumentit te publikuar. Edhe pse kjo konsiderohet si mbivendosje e ligjit, kjo eshte me interes te madh ekonomik, teknik dhe urbanistik per njesine administrative ku do te kryhen punimet.

Gjithashtu, mbetet po ai formulim edhe per Neni 3 te dokumentit te publikuar, mbasi kjo eshte e domosdoshme per mbrojtjene rrjeteve egzistues te komunikimit elektronik si dhe te atyre komunale nga demtimet gjate punimeve per ndertimin e rrjeteve te reja.

4. Sipas pikes 2.16 te Dokumentit te Keshillimit Publik, percaktohet se rrjeti shperndares me fiber optike apo kabell bakri mund te planifikohet ajror vetem nese eshte i lejuar nga dokumenti i planifikimit te territorit.

Vodafone Albania propozon qe te cilesohet “vetem nese eshte i lejuar nga dokumenti i planifikimit te territorit, ne baze te Ligjit Nr. 10119, date 23.04.2009 “Per planifikimin e territorit”.

AKEP pranon qe formulimi i Paragrafit 2.16 te behet sipas ketij propozimi.

5. Neni 4 i Dokumentit te Keshillimit Publik percakton detyrimin e operatoreve qe te raportojne informacion specifik per shtrirjen e rrjeteve te komunikimeve elektronike. Ky informacion botohet per publikun.

Vodafone Albania konsideron se ky rregull eshte i tepert per natyren e ketij dokumenti. AKEP e ka tashme detyrim ne baze te Ligjit 9918 qe te jete ne dijeni te informacionit mbi shtrirjen e rrjeteve te komunikimit elektronik.

Po ashtu, nuk mund te anashkalohet edhe plani per krijimin e nje sistemi te perqendruar informacioni per rrjetin ne baze te Projekt Ligjit per te Drejten e Kalimit. AKEP eshte i angazhuar ne kete projekt teper te rendesishem dhe eshte faktikisht mbajtessi i sistemit te informacionit te perqendruar mbi te drejttat e kalimit (qe perfshin edhe informacionin mbi shtrirjen e rrjeteve).

Per kete arsye neni 4 duhet te hiqet qe te mos krijoje mbivendosje me Projekligjin per te Drejten e Kalimit dhe per moskrijimin e detyrimeve shumefishe te raportimit per te njejten ceshtje. Po ashtu, botimi i informacionit per publikun duhet te jete i kontrolluar duke marre parasysh dhe nevojat e sigurise fizike te rrjeteve te tilla.

AKEP mendon te mbetet formulimi i percaktuar ne dokumentin e publikuar. Kjo eshte e nevojshme per eliminimin e fshehjes se informacionit nga operatore te ndryshem.

6. Pika 26.4 percakton se kerkesat per hapësirën ndarese të kabllave telefoni/data nga kabllot e fuqisë e të tensionit jepën në standardin EN 50174-2: 2009.

Vodafone Albania konsideron se standardi korrekt per instalime jashte ndertese eshte: EN 50174-3 Information technology. Cabling installation. Installation planning and practises outside buildings. Standardi EN 50174-2: 2009 vlen per instalime brenda ndertesave.

AKEP eshte dakort qe ne Paragrafin 26.4 te shtohet edhe standardi EN 50174-3

7. Sipas pikes 26.6, gjate hartimit te projekteve te infrastruktures se rrjeteve telefonike e kabllore urbane, duhet te parashikohet ruajtja e ketyre largesive nga tubat e ujesjellesit, gazsjellesit, naftesjellesit dhe te ngrohjes:

Largesia minimale e kabllave sipas llojeve te tubacioneve jepet si me poshte:

- a. Tubacion gazi: 1 meter
- b. Tubacion avulli: 1 meter
- c. Tubacion nafte: 1.5 meter
- d. Tubacion magistral ujesjellesi: 2.0 metra
- e. Tubacion i zakonshem ujesjellesi: 0.6 metra

Vodafone Albania propozon te shtohet edhe pika f. Tubacioni i ujrave te zeza: 0.7 metra.

AKEP bie dakort qe ne Paragrafin 26.6 te shtohet edhe pika f.

8. Pas pikes 31.4 te dokumentit te Keshillimit Publik, me kete permbajtje:
Trosi mbajtes mund te jete pjese e vete kabllit, qysh nga prodhimi i tij ne fabrike. Keto kablllo quhen kabllot e vetevarura (selfsupporting cable). Ne keto raste, trosi prej celiku eshte i vendosur ne fabrike sebashku me kabllin, i llogaritur per te mbajtur peshen totale per nje kampate mesatare prej 50 metra. Ne keto raste, te dhenat mekanike te kabllave te vetevarura duhet te njihen paraprakisht nga projektuesi.

Vodafone Albania propozon qe te shtohet paragrafi 31.5:

31.5 Ne rastin e kabllave optike te pajisura me tros mbajtes, mund te perdoret infrastruktura ekzistuese e shtyllave per linjat elektrike per te fiksuar kabllin. Perverc rregullave te pergjithshme te dhena ne paragrafin 31.6 aspektet e meposhtme duhen marre parasysh ne fazen e projektimit dhe instalimit te kabllit per te siguruar plotesisht jeten e punonjesve dhe komunitetit dhe eliminuar ndikimin ne funksionet e kabllit:

1. Kushtet specifike klimatike (periudhat me kohe te thate, me shi, mjegull, lageshti, vese)
2. Te dhenat teknike te kabllit
3. Zgjedhja e pozicionit te pershtatshem ne shtylle duke marre parasysh:
 - a. Respektimi i distances se sigurise ndermjet kabllit dhe percjellsave,
 - b. Ekzistencen e hapësirave te mjaftueshme per punonjesit qe ktyejne instalimet dhe mirembajtjen,
 - c. Zvogelimi i fushes elektrike, reniet e tensionit dhe rrjedhjeve te rrymes elektrike pergjate kabllit per te eliminuar burimet e fenomenit te kurores dhe shkarkimeve te pjeseshme elektrike ne kabell qe mund te sjellin demtim te mbuleses se kabllit.

AKEP vendos qe te mbeten formulimet e paraqitura ne dokumentin e publikuar.

9. Sipas pikes 31.8, te Dokumentit te Keshillimit Publik, ndalohet kategorikisht vendosja e kabllave ajrore me cfardolloj mbulesa ne te njejtin tros mbajtes ku jane prezente linja te cdo lloj tensioni elektrik.

Vodafone Albania propozon qe te shtohet ne fund nje perjashtim pasi aktualisht kjo praktike perdoret nga OST (Operatori i Sistemit te Transmetimit). Me konkretisht:

31.8 Ndalohet kategorikisht vendosja e kablllove ajrore me cfardoltoj mbulesa ne te njejtin tros mbajtes ku jane prezente linja te cdo lloj tensioni elektrik. Perjashtohen rastet kur trosi inkorporon edhe kabllin optik (trosi dhe kablli jane te integruar).

AKEP gjykon qe te mbetet formulimi i paraqitur ne Paragrafin 31.8 te dokumentin e publikuar.

- 10.** Sipas pikes 27.5 te Dokumentit te Keshillimit Publik, rrjeti i telefonise brenda zonave urbane eshte trajtuar me tre sektore, me qe 95% e rrjetit ekzistues eshte ndertuar si e tille.

Vodafone Albania konsideron se ky eshte nje paragjykim i theksuar teknologjik. Po ashtu, eshte e interesuar te dije se cfare ndikimi ka nga nje rregull i tille.

AKEP sqaron se ne Dokumentin per Keshillim Publik, nuk perjashtohet ndonje variant tjeter teknologjik, por ka trajtuar edhe rastin e rrjeteve urbane me tre sektore. Kjo eshte e nevojshme per faktin se sot ne te gjitha qytetet e Shqiperise, mbi 95% e te gjitha rrjeteve kabllore egzistuese jane te ndertuar ne tre sektore. Ne nuk mendojme se keto rrjete ekzistuese do te abandonohen pas hyrjes ne fuqi te kesaj rregullore. Duke e lene formulimin sic eshte parashikuar ne kete dokument, ndikimi do jete shume pozitiv, pasi te gjitha operatoret qe jane pronare te ketyre rrjeteve egzistuese, do t'u vihet afat kohor per t'i sjelle keto rrjete ne perputhje te plote me kushtet teknike qe percakton kjo rregullore. Ndikimi do jete pozitiv ne cilesine teknike te rrjeteve, ne qendrueshmerine fizike te tyre, por edhe ne eliminimin e katraures urbane qe sot eshte prezente ne te gjitha qytetet tona.

- 11.** Ne kuader te komentit tone me siper per heqjen e nenit 4, Vodafone Albania sugjeron heqjen e neneve 34.1 dhe 34.2 me siper.

Vodafone Albania konsideron se nuk ka nevojte qe te miratohen keto pika persa kohe qe nuk miratohet as Neni 4 i ketij Dokument per Keshillimin Publik. Po ashtu, nuk ka asnje kuptim qe te miratohet pika 34.1 e cila mund te kishte kuptim vetem ne kontekstin e detyrimit per te dhene informacion per sistemin e perqendruar te informacionit sipas nenit 4.

AKEP i qendron formulimit te paraqitur ne dokumentin e publikuar.

III. Albanian Mobile Communications

- 1.** Ne Kapitullin e Parimeve te Pergjitheshme, Neni 2, Paragrafi 2.2, nuk del e qarte se cfare kuptohet me "subjekt i licensuar per kete lloj aktiviteti".

Ky referim duhet te zgjerohet per te dale me qarte nese flitet per:

a. nje subjekt/operator i komunikimeve elektronike qe planifikon dhe nderton vete infrastruktura kabllore dhe me fibra optike, ne baze te Autorizimit te Pergjithshem.

- b. nje subjekt te licensuar per kryerjen e punimeve civile ne pergjithesi dhe qe kontraktohet nga operatorët e infrastruktures kabllore dhe me fibra optike.
- c. Nje subjekt qe ka marre nje License te vecante per ndertimin e infrastruktures kabllore dhe me fibra optike ne te gjithë territorin.

AKEP e konsideron të drejtë vërejtjen dhe riformulon Paragrafin 2.2 të Nenit 2 si me poshte:

“2.2 Infrastruktura e rrjeteve kabllore dhe fibrave optike te planifikohet dhe ndertohet nga operatore te komunikimeve elektronike fikse dhe celulare, ose nepermjet subjekteve te licensuar per kete lloj aktivitet”i.

2. Ne Kapitullin e Parimeve te Pergjitheshme, Neni 2, Paragrafi 2.8, kemi nje reference qe e lidh planifikimin dhe ndertimin e kesaj infrastrukture me operatorët e telefonise fikse te komunikimeve elektronike, duke perjashtuar ne nje fare menyre operatorët e telefonise celulare, te cilet e konsiderojne infrastrukturen me fibra optike si shume te rendesishme per rrjetet e tyre te transmetimit.

Prandaj , do te sugjerojme qe ne dokumentin rregullator te shprehet qarte (mundet ne Piken 2.2 te Nenit 2) qe infrastruktura e rrjeteve kabllore dhe fibrave optike mund te planifikohet dhe ndertohet edhe nga operatore te komunikimeve elektronike fikse dhe celulare vete ose nepermjet subjekteve te licensuar per kete lloj aktiviteti.

AKEP e konsideron të drejtë vërejtjen dhe riformulon Paragrafin 2.8 të Nenit 2 si meposhte:

“2.8 Kur kanalet kabllore planifikon t’i ndertoje operatori i infrastruktures, i cili eshte nje operator i telefonise fikse ose celulare te komunikimeve elektronike, dhe ne planin urbanistik nuk eshte percaktuar kapaciteti i kanaleve kabllore te planifikuara, atehere ky kapacitet duhet te jete 30% me shume se sa eshte e nevojshme per kete operator te rrjeteve te komunikimeve elektronike.”

3. Ne listen e profileve te kanaleve te kalimit te bitubit, te pershkruara ne dokument, ne propozojme qe te perfshihet edhe i ashtuquajture mini-trenching. Mini-trenching eshte nje profil kanali me permasa 10cm x 55cm (gjeresi x lartesi), i cili mund te konsiderohet nje variant i thjeshte, i shpejte per t’u ndertuar dhe me kosto te lire. Ky variant perdoret shume edhe ne vende te tjera.

AKEP mendon qe edhe profili i propozuar t’i shtohet listes se profileve qe jane ne dokumentin e publikuar, por ve ne dukje se edhe profilet e tjera te publikuara jane rekomandime per raste te ndryshme qe gjithmone miratohen nga autoriteti qe jep lejen e infrastruktures.

4. Gjithashtu, duke perfitur nga ky rast, AMC deshiron te theksoje se se ka qene dhe eshte ne pritje te menyres se dhenies se licensave te pergjithshme per ndertimin e infrastruktures se nje rrjeti me fibra optike ne nivel kombetar, ne perputhje me planin e veprimeve te prezantuar nga AKEP dhe MITIK.

Ne do te kerkonim qe te pershpejtohen procedurat, ne menyre qe te hapet perspektiva e zhvillimit te rrjeteve te operatoreve te komunikimeve elektronike ne drejtim te ofrimit te sherbimeve me brez te gjere.

Shpresojme qe perfundimi i ketij keshillimi publik te ndiqet nga zhvillime pozitive ne drejtim te krijimit te mundesise qe operatorët e interesuar per investime ne ndertimin e

rrjeteve me fibra optike te kene mundesi t'i kryejne ato pa pengesa nga autoritetet qe i leshojne lejet perkatese.

AKEP gjykon se keto sugjerime jane jashte kuadrit te ketij dokumenti.

IV. Ministria e Brendshme

Sugjeron si me poshte:

1. Infrastruktura e kanaleve kabllore te ndertohet pasi te jete shprehur Keshilli Rregullues i Territorit (KRrT) prane Njesise Vendore perkatese.

AKEP gjykon qe ky sugjerim nuk ka lidhje me kushtet teknike qe paraqet ky dokument i publikuar.

2. Gjithashtu ne perputhje me teknikat legjislative, projekt-rregullores t'i bashkelidhet dhe relacioni perkates.

Për këtë akt relacioni shpjegues ishte i vlefshem per Keshillin Drejtues dhe i eshte paraqitur atij.

V. Albtelecom sh.a.

Ne vijim jepen disa nga kushtet teknike qe jane te detyrueshme per t'u zbatuar gjate projektimit dhe zbatimit te rrjeteve kabllore te telekomunikacioneve.

1. Shtrirja e kablllove ajrore vetembajtese ose me trose mbajtese.

1/1. Ne raste urgjente si dhe ne zona te qendrave te banuara, ku nuk ka perfunduar infrastruktura e rende nentoksore (rruge, trotuare, kanalizime te ujrave te bardha e te zeza, etj), mund te parashikohet dhe zbatohet vendosja e kablllove te telekomunikacioneve ne shtyllezim ajror.

AKEP gjykon te mbetet formulimi i Paragrafit 31.1 te dokumentit te publikuar.

1/2. Ne keto raste mund te perdoren kablllo ajrore vetembajtese, pra kablllo te destinuar qe nga prodhimi per vendosjen e tyre ne ajer. Ketyre kablllove ju "bashkengjitet" trosi prej celiku qe ne fabrike gjate procesit teknologjik te prodhimit dhe zakonisht ky tros eshte i llogaritur per te mbajtur peshen totale per nje kampate me gjatesi mesatare 50ml.

AKEP gjykon te mbetet formulimi i Paragrafit 31.4 te dokumentit te publikuar.

1/3. Troset mbajtes prej celiku te zinkuar fiksohen ne mure, fasada, shtylla druri, ose prej betoni, etj. Ne rastin e vendosjes ne shtylla duhet te behet perforcimi i shtyllave me aksesoret perkates (kundrashtylla, tiranda, tenditore, etj) per te ekuilibruar forcen terheqese te trosit, peshen e kablllove dhe sforcime te tjera me prejardhje faktoret atmosferike. Ne te njejten kohe keto shtylla duhet te projektohen dhe pajisen me rrufeprites ne forme shtize ne largesi 250ml nga njeri tjetri.

Rezistenca e tokezimit te ketyre rrufepritesve duhet te jete $R \leq 10\text{ohm}$.

AKEP gjykon se komenti i dhene ne kete paragraf eshte shume i pergjithshem dhe shume i zgjeruar. Ai perfshin trosin me tel zinku, shtyllen, kundershlyllen, tenditorët, etj. Te gjitha keto jane trajtuar vec e vec ne dokumentin e publikuar.

1/4. Trosi metalik duhet te kete vazhdimesi elektrike gjate gjithë gjatesise. Ne rastet kur trosët metalike jane te xhveshur, ne te dy skajet e trosit behet tokezim si dhe ne cdo 250m. Rezistenca e tokezimit te ketyre rrufepritesve duhet te jete $R \leq 10\text{ohm}$.

AKEP gjykon te mbetet formulimi i paraqitur ne Paragrafin 31.10 te dokumentit te publikuar.

1/5. Gjate projektimit dhe zbatimit duhet te parashikohet qe gushat te mos bien gjate kampatave ajrore. Gushat duhet te behen ne skajet e kampatave, prane shtyllave, ku lihet edhe nje rezerve kablli prej 2m, qe nevojitet per gushat e reja ne rast avarie te gushave egzistuese.

AKEP sqaron se kjo eshte trajtuar ne Paragrafin 31.11 .

1/6. Lartesia minimale e kabllave telefonike urbane te varura ne trose, ne kushtet me te disfavorshme te ngarkeses dhe te temperatures, nuk lejohet me e vogel se 7m gjate intersektimit te rrugeve dhe hekurudhave dhe jo me vogel se 4.5m gjate traseve, ku nuk parashikohet levizje automjetesh ose mekanizmash te tjere.

AKEP shton në dokumentin e publikuar si paragraf me vehte 31.17 .

2. Intersektimi i kabllave ajrore te telekomunikacioneve me linjat ajrore elektrike.

2/1. Ne rastet kur gjendet e paevitueshme nga projektuesi, parashikohen ne projekt nderprerje/intersektime te kabllave ajrore te telekomunikacioneve me linjat ajrore te rrjetit elektrik te tensionit te ulet (T.U. konsiderohen ato deri ne 1kv), apo te tensionit te larte (T.L. konsiderohen ato mbi 1kv).

Ne cdo rast te tille parashikohet qe kabllot ajrore te telekomunikacioneve duhet te vendosen gjithnje me poshte/me ulet se linjat e rrjetit elektrik dhe duke i respektuar me rigorozitet gjate zbatimit, largesite e lejuara sipas normave teknike te treguara ne vijim:

Tensioni i linjes elektrike (ne kilovolt)	Largesia minimale e linjes se telekomunikacionit nga linja e tensionit elektrik (ne m.l)
deri ne 1kv	1.25ml
mbi 1-20kv	2.00ml
mbi 20-110kv	4.00ml
mbi 110-220kv	5.00ml
mbi 220-330kv	7.00ml

2/2. Largesia horizontale nga shtylla e kampates se kablllove te telekomunikacionit deri tek percjellesi me i afert i linjes se tensionit te larte, duhet te jete jo me pak se 10.0m .

2/3. Ndalohet kategorikisht vendosja e linjave/kablllove ajrore te telekomunikacioneve mbi/me lart se linjat e rrjetit elektrik.

2/4. Ndalohet kategorikisht mbeshetja e troseve mbajtes dhe e kablllove telefonike urbane ajrore, me cfaredo lloj mbulese, ne shtyllat elektrike te cdo tensioni.

Per shkarkuesit e shtyllave dhe trosin mbajtes

Shkarkimet atmosferike apo dhe linjat e tensionit te larte mund te bien edhe direkt ne rrjetin/shtyllezimin ajror dhe ne keto raste mund te shkaktojne shkaterrimin e shtylles, djegien e keputjen e saj dhe te rrjetit si dhe pasoja te tjera per personelin, rrjetin, sistemet operuese etj.

Per mbrojtjen e rrjeteve/shtyllezimeve ajrore nga shkarkimet atmosferike direkte, ne shtyllat e rrjetit ajror instalohen shkarkuesit e linjes.

Keta shkarkuesit vendosen ne shtyllat fundore, te kontrollit, te ndarjes/degezimeve, te kendeve, te kalimeve (lumenj, perrenj,etj), te kryqezimeve ne rrjetin elektrik si dhe ne shtylla te tjera qe dominojne ne lartesi ne nje terren te caktuar: psh nje shtylle e ndodhur ne nje lartesi te ndjeshme ndaj shtyllave para e pas ardhese te ndodhura ne terren fushor. Gjithashtu pajisen me shkarkues edhe shtyllat e ndermjeme qe gjate shfrytezimit demtohen nga shkarkimet atmosferike pamvaresisht ne se jane pajisur shtyllat fqinje. Ne se nje shtylle qe priset nga shkarkimet atmosferike, zevendesohet me nje shtylle te re atehere kjo e fundit duhet gjithashtu te pajiset me shkarkues.

Shkarkuesi i linjes ndertohet me tel celiku me diameter $\Phi \geq 4\text{mm}$, i cili qendron 5-7cm mbi majen e shtylles dhe mberthehet me thumba "U" ne cdo 30 cm , pergjate shtylles sic tregohet ne fig.1.

Kur linja e telekomunikacionit intersektohet me linjen elektrike qe ka tension 3000v dhe me shume, ne shtyllat e linjes se telekomunikimit, qe kufizojne kasmpaten e intersektimit, shkarkuesit duhet te vendosen me interval ajror prej 5cm ne distance 30cm nga niveli i tokes , sic tregohet ne fig 2.

Teli i shkarkuesit vazhdon gjate shtylles ne thellesine 0,7ml dhe me tej vazhdon nen toke normal me drejtimin e linjes ne gjatesine L, ku behet lidhja me elementin tokezues.

Per shtyllat fundor, te kablllove, te kendeve, te kalimeve e degezimeve, elementi tokezues duhet te plotesoje kushtin qe rezistenca e tokezimit te jete $\leq 10\Omega$.

Per shtyllat qe jane ne kampaten e intersektimit me linjat e tensionit te larte, duhet qe elementi tokezues te plotesoje kushtin qe rezistenca e tokezimit te jete $\leq 5\Omega$.

Shtyllat ku do te vendoset shkarkuesi i linjes percaktohen nga projektuesi, gjate shkeljes se terrenit per hartimin e projektit, por mund te plotesohen me tej edhe me te tjere qe i dikton praktika e shfrytezimit te rrjetit ajror.

Gjatesia L zgjidhet ne funksion te terrenit/tokes ku ndodhet shtylla dhe percaktohet sipas tabelës me poshte.

Gjatesia e telit per lidhjen e shkarkuesit (ne m.l)

Lloji i tokes	Ne shtyllat fundor, te kablllove,te kendeve, te kalimeve e degezimeve	Ne shtyllat qe jane ne kampaten e intersektimit me linjat e tensionit te larte
Mocalore	1	2
E zeze	1	3
Argjilore	1.5	4
Me delte	2	5
Me rere	5	9
Rere deti	6	15
Rere me lageshti mesatare	7	25
Gurore	8	35

Ne shtyllat qe jane ne kampaten e intersektimit me linjat e rrjetit elektrik, vec shkarkuesit te linjes eshte e domosdoshme te ndertohet edhe rrjeta/ trosi mbrojtës per te evituar kontaktin direkt te rrjetin telekomunikimit me rrjetin elektrik ne rastin e keputjes se fijeve te ketij te fundit.

Ne figuren 3, paraqitet skema e rrjetes/ trosit mbrojtës qe pengon renien e percjellesave te keputur te rrjetit elektrik ne rrjetin e telekomunikimit ne kampatat e intersektimit te tyre.

Per kete mbi armaturen e rrjetit telekomunikimit ne cdo shtylle te intersektimit montohet nje traverse, gjatesia e se ciles duhet te jete minimalisht 7cm me e gjate se armature e rrjetit telekomunikimit. Ne keto traversa montohet rrjeta mbrojtëse me 4-6 percjellesa zingu me $\Phi \geq 4\text{mm}$, te lidhur paralelisht dhe dy percjellesa te tjere te lidhur sipas diagonaleve.

Te gjithë keta percjellesa lidhen elektrikusht/saldohen ne te dy anet me shkarkuesit e shtyllave perkatese, ku rezistenca e tokezimit duhet te plotesoje kushtin qe te jete $\leq 5\Omega$.

AKEP gjykon se te gjitha ceshtjet e trajtuara ne piken 2 te komenteve te derguara nga ky operator, jane vertete te rendesishme per t'u patur ne konsiderate gjate projektimit te rrjeteve kabllore ajrore, por qe nuk mund te trajtohen ne kete dokument, i cili objekt te tij ka infrastrukturen e rrjeteve.

VI. MITIK

Neni 1:

Te shikohet riformulimi i pikes 1.3 pasi del si perseritje e pikes 1.1

AKEP gjykon se Pika 1.3 nuk perserit Piken 1.1 por zgjeron objektin e kesaj Rregulloreje duke perfshire ne te edhe permiresimin ose zgjerimin e infrastrukturës se rrjeteve egzistuese. Mendojme qe te mbetet formulimi sic eshte ne dokumentin e publikuar.

Pika 1.4 duket si pertej kompetencave te AKEP.

AKEP gjykon se formulimi ne Piken 1.4 eshte ne perputhje me kompetencat qe percakton Ligji Nr. 9918. Per kete arsye mbetet formulimi sic eshte ne dokumentin e publikuar.

Ne Piken 1.5 te qartesohej se nga kush institucion behet rishikimi periodik i rregullave qe lidhen me teknikat e ndertimit etj.

AKEP sqaron se institucioni i vetem per te hartuar dhe rishikuar rregullore per komunikimet elektronike dhe infrastrukturen e tyre eshte AKEP. Per kete arsye mendojme se ne kete rast sakesimi i emrit te institucionit nuk eshte i nevojshem. Keshtu qe Pika 1.5 te mbetet sic eshte ne dokumentin e publikuar.

Pika 1.7 duket sikur nuk percakton nje rregull apo kerkese, por me shume si pjese e nje relacioni shpjegues.

AKEP e konsideron verejtjen, por nga ana tjeter sqarojme se Pika 1.7 eshte e perfshire ne "Hyrje", ku eshte e arsyeshme qe te jepen edhe spjegime te tilla. Per kete arsye AKEP i qendron formulimi sic eshte ne dokumentin e publikuar.

Te rishikohet Pika 1.9 dhe perputhshmeria me Piken 1.4 . Ne Pike 1.4 thuhet qe keto rregulla percaktojne kerkesat teknike, nderkohe ne Piken 1.9 jepet percaktimi se kerkesat teknike jane sipas legjislacionit ne fuqi.

AKEP konstaton se nuk egziston ndonje mosperputhje midis pikave 1.4 dhe 1.9 . Pika 1.4 spjegov se ne kete rregullore trajtohen teknikat e kryerjes se punimeve civile, kurse Pika 1.9 rekomandon zbatimine e ligjeve dhe dispozitave ne fuqi gjate kryerjes se punimeve civile.

Neni 2:

Sugjerojme te rishikohet me kujdes per ta sjelle ne harmoni me Ligjin No. 10119, date 23.4.2009 "Per planifikimin e territorit" i ndryshuar. Ne vecanti verejme se kerkesat qe vihen ne adrese te sipermarresit qe nderton rrjete te komunikimeve elektronike, duhet te jene ne vemendje te autoriteteve qe sipas Ligjit No. 10119, date 23.4.2009 "Per planifikimin e territorit" i ndryshuar, japin lejet e infrastruktures dhe mbikqyrin respektimin e kerkesave per ndertimin e tyre.

AKEP gjykon se shqetesimi i mesiperm eshte patur parasysh dhe tashme konsiderohet i ezauruar pasi ky dokument i publikuar eshte konsultuar edhe nga Agjensia Kombetare e Planifikimit te Territorit.

Ne kete nen krijohet nje konfuzion ne perdorimin e termave te ndryshem si sipermarres, operator i infrastruktures, investitor, operator i telefonise fikse,

subjekte te licensuar per kete lloj aktiviteti (pa cilesuar aktivitetin apo nga cili institucion licensohet). Ky konkluzion lidhet edhe me faktin qe nuk kemi nje nen per perkufizimet ne projekt rregullore.

Verejtja per perdorimin e termave te ndryshem eshte me vend. Megjithate, theksojme se perdorimi i kesaj terminologjie eshte bere ne menyre te kujdeseshme. Lidhur me terminologjine e perdorur, ne varjantin perfundimtar qe u është paraqitur, tashme jane bere ndryshime bazuar edhe ne verejtjet e bera nga subjektet e tjera.

Pika 2.7 dhe pika 2.11 kane nevoje te rishikohen pasi kane perseritje.

AKEP eshte dakord me verejtjen e bere dhe vendos që ne vend te pikes 2.7 te mbetet vetem formulimi i Pikes 2.11 .

Ne lidhje me Piken 2.10 parashikohet inspektim por pa cilesuar nga cili autoritet.

AKEP gjykon se nuk eshte objekt dhe kompetence e kesaj rregulloreje te percaktoje autoritetet qe kryejne inspektimin e punimeve ndertimore. Keshtu qe te mbetet formulimi sic eshte ne dokumentin e publikuar.

Ne lidhje me Piken 2.16 te shikohet mundesia e kufizimit te lejimit te shtrirjes se rrjetit me fiber optike ajrore.

AKEP gjykon te mbetet formulimi sic eshte ne dokumentin e publikuar.

Ne pergjithesi pikat 2.17 deri 2.20 duket sikur jane jashte objektit te kesaj rregulloreje dhe rregullohet me aktet perkatese te ndertimit ose planifikimit te territorit.

Ky kanstatim eshte i diskutueshem. AKEP gjykon se pikat 2.17 deri ne 2.20 te mbeten ne kete rregullore, pavaresisht se keto kerkesa mund te jene trajtuar edhe ne rregullore te autoriteteve te tjera. Nje gje e tille ka vetem vlera pozitive per kete rregullore.

Neni 4:

Ne lidhje me parashikimin e Pikes 4.1, sugjerojme te riformulohet duke pasur parasysh qe sipermarresi, ka per detyre jo vetem te mbaje, perditesoje informacionin e detajuar per rrjetin e tij, por edhe t'ia vere ne dispozicion autoriteteve pergjegjese (shih neni 92, ligji nr. 9918, date 19.5.2008 (Per komunikimet elektronike ne Republiken e Shqiperise”))

AKEP mendon se kjo kerkese eshte e plotesuar ne Nenin 4.2. Keshtu qe mbetet formulimi sic eshte ne dokumentin e publikuar.

Ne pergjithesi projekt-rregullorja ka nevoje per harmonizim te terminologjise se perdorur me termat e dhena ne ligjin nr. 9918, date 19.5.2008 “Per komunikimet elektronike ne Republiken e Shqiperise”. Ne vecanti verehet perdorimi i disa

termave: kablllo te komunikimeve elektronike, kablllo telefonike, kablllo telefoni data, kanali kablllor etj.

AKEP sqaron se nje pjese e terminologjise se perdorur ne kete rregullore (ndertim infrastrukture) nuk eshte e percaktuar ne termat e dhena ne Ligjin Nr. 9918, date 19.05.2008 .

Ne teresi te sakesohet per te shmangur konfuzionin qe krijohet ne referenca diku sipermarresit, si shfrytezues i rrjetit, diku i referohemi ndertuesit, firmes ndertuese te rrjetit. Si do te rregullohet kjo marredhenie dhe nga kush? AKEP rregullon dhe mbikqyr veprimtarine e sipermarresve te komunikimeve elektronike, operatoret.

AKEP sqaron se marredheniet ndermjet sipermarresve dhe autoriteteve pergjegjese rregullohen sipas percaktimit ne Piken 2.4 te kesaj Rregulloreje si dhe Ligjit No. 9918 date 19.05.2008 “Per Komunikimet Elektronike ne Republiken e Shqiperise”.

Neni 5:

Per Piken 5.1 dokumenti teknik duhet hartuar edhe ne menyre elektronike.

AKEP eshte dakort me sygjerimin dhe rishikon formulimin si me poshte vijon:

5.1 Ndërtimi i nje kanali kablllor duhet të bëhet sipas një projekti teknik, i cili duhet te reflektoje normat teknike te sakesuara ne kete rregullore. Dokumentacioni teknik duhet hartuar edhe ne mënyrë elektronike.

Ne Piken 5.7 te sakesohet ku paraqitet informacioni per aplikimin per leje, per sistemin e informacionit te perqendruar sipas Pikes 4.2 etj.

AKEP sqaron se Pika 5.7 nuk trajton aplikimin per leje, por trajton informacionin e dokumentacionit teknik lidhur me infrastrukturen e kanalit kablllor.

Neni 24:

Te shikohet mundesia e kufizimit te perdorimit te rrjetit kablllor ajror. I njejti sugjerim edhe per Piken 30.1 .

AKEP sqaron se Neni 24 vetem percakton llojet e instalimeve te rrjetave kablllore urbane. Aty nuk trajtohet perdorimi i rrjeteve kablllore. Keshtu qe formulimi mbetet sic eshte ne dokumentin e publikuar.

Neni 26:

Pika 7. nuk percaktohet se cilat jane dispozitat ligjore ne fuqi.

Lidhur me kete verejtje eshte e nevojshme per t'u sqaruar dispozitat, normat, apo urdheresat perkatese qe jane leshuar nga dikasteret (?!).

Neni 31:

Te shikohet me kujdes i gjithe Neni 31. per te kufizuar perdorimin e rrjetit kabllor ajror.

AKEP sqaron se ky nen trajton anen teknike per ndertimin e infrastruktures se rrjeteve kabllore ajrore dhe nuk trajton perdorimin e rrjetit kabllor ajror. Perdorimi i rrjetit kabllor ajror eshte trajtuar vecanerisht ne Nenin 30. AKEP i qendron formulimit sipas dokumentit te publikuar.

Neni 34:

Formulimi i Pikes 1, eshte kontradiktor ne faktin: "... per aq sa eshte e mundur, jane detyruese.."

Ne vijim bie ne kundershkrim me hyrjen e Nenit 1 ku thuhet se: "AKEP nepermjet kerkesave te kesaj rregulloreje u vjen ne ndihme sipermarresve qe veprojne.."

AKEP gjykon se nuk ka asnje kontradikte midis formulimit te Pikes 34.1 dhe Hyrjes ne Nenin 1. Neni 34.1 trajton vetem rastet e infrastrukturës egzistuese qe jane ndertuar perpara hyrjes në fuqi të saj te kesaj rregulloreje, prandaj edhe eshte trajtuar si dispozite tranzitore e vecante.